# Agjërimi

## Përkufizimi i agjërimit:

Agjërimi është adhurim ndaj Allahut që arrihet nëpërmjet përmbajtjes dhe privimit nga ngrënia, pirja, marrëdhëniet seksuale dhe të ngjashme me to, prej agimit - që është koha e thirrjes së ezanit të sabahut, deri në perëndim të diellit, - që është koha e thirrjes së ezanit të akshamit.




Allahu e obligoi **agjërimin e muajit të Ramazanit** dhe e bëri atë prej shtyllave të Islamit.

dhe na inkurajoi që **veç tij** të agjërojmë prej ditëve të preferuara (të zgjedhura)

## Qëllimi i agjërimit:



**Përmbushja e devotshmërisë** përmes privimit nga gjërat e lejuara, për një kohë të caktuar, që bëhet si adhurim ndaj Allahut. Kështu, personi heq dorë nga ngrënia, pirja dhe epshi i tij, duke synuar kënaqjen e Allahut.



**Forcimi i vullnetit dhe vendosmërisë,** duke qenë se muslimanit, që arriti të dominojë epshin dhe pasionet e tij, si dhe të privohet nga diçka që është e lejuar për të në pjesën tjetër të ditëve të veta, duke e bërë këtë si adhurim ndaj Allahut, i forcohet vendosmëria e tij për t'u privuar nga ajo që Allahu ia ka ndaluar në çdo kohë.



**Përforcimi i ndjesisë së mbikëqyrjes së Allahut** në unin e personit, sepse agjërimi është midis Allahut dhe robit dhe dihet se njeriu mund të fshihet diku për të ngrënë dhe pirë; por përderisa ai i shmanget kësaj gjëje, duke kërkuar atë që gjendet tek Allahu (shpërblimin e Tij), kjo përbën ushtrimin më të mirë të ndjesisë së mbikëqyrjes së Allahut, në vetmi dhe në publik.



**Përkujtimi i të mjeruarve dhe nevojtarëve:** kemi të bëjmë me një përjetim konkret të urisë dhe etjes, që na kujton vëllezërit tanë, të cilët nuk kanë se çfarë të hanë dhe të pinë. Së këtejmi inkurajohemi, për t`u përpjekur që t`iu japim atyre dorën e ndihmës.

## Mirësia e agjërimit:



**Allahu i Lartmadhëruar ia ka atribuar Vetes dhënien e shpërblimit për agjërimin.** Kush pret shpërblimin nga Bujari, i Madhërishmi, Mëshirëploti, le të gëzohet për atë që i ka përgatitur Allahu. Profeti (Paqja qoftë mbi të!) thotë: "Çdo vepër e birit të Ademit (njeriut) është për të, përveç agjërimit; ai është vetëm për Mua (Allahun) dhe vetëm Unë di se si e shpërblej atë". (El-Bukhari 1805, Muslimi 1151).

**Atij që agjëron Ramazanin me besim tek Allahu,** duke iu bindur urdhrave të Tij, duke e besuar atë që është transmetuar në lidhje me mirësitë e këtij muaji dhe duke shpresuar shpërblimin që ka premtuar Allahu, **do t'i falen gjynahet e mëparshme.** Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Kush e agjëron Ramazanin me besim (te Zoti) dhe me shpresë (te shpërblimi i Tij), do t'i falen gjynahet e mëparshme". (El-Bukhari 1910, Muslimi 760).

**Agjëruesi do të gëzohet për shpërblimin dhe begatitë që do të fitojë** për shkak të agjërimit, **kur të takojë Allahun.** Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Agjëruesi ka dy gëzime: një gëzim kur çel iftar dhe një gëzim kur të takojë Zotin e tij" (El-Bukhari 1805, Muslimi 1151).

**Në Xhenet ka një portë, - e cila quhet Rejan - nga ku do të hyjnë vetëm agjëruesit.** Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Vërtet në Xhenet ndodhet një portë, që quhet Rejan, nga e cila do të hyjnë agjëruesit Ditën e Kiametit dhe nuk do të hyjë askush tjetër veç tyre" (El-Bukhari 1797, Muslimi 1152).

## Personat e justifikuar (lidhur me agjërimin) dhe gjërat që e prishin (atë)




### Personat e justifikuar lidhur me agjërimin e Ramazanit

**I sëmuri** i cili dëmtohet nga agjërimi. Ai lejohet të ushqehet dhe ta zëvendësojë agjërimin pas Ramazanit.

**I pafuqishmi që nuk e përballon dot agjërimin** për shkak të moshës së thyer apo një sëmundjeje nga e cila nuk pritet të shërohet. Një person i tillë lejohet të mos agjërojë, por për çdo ditë agjërimi duhet të ushqejë nga një të varfër, duke i dhënë një kg e gjysmë (1.5 kg) nga ushqimi bazë i vendit ku jeton.

**Udhëtari** gjatë udhëtimit dhe qëndrimit (akomodimit) të tij të përkohshëm, i lejohet të mos agjërojë, por duhet ta zëvendësojë pas Ramazanit atë që ka lënë pa agjëruar.

**Gruaja me menstruacione dhe lehona** Këto të dyja e kanë haram (të ndaluar / të paligjshme) të agjërojnë dhe agjërimi i tyre është i pasaktë. Ndërkaq ato duhet t'i zëvendësojnë pas Ramazanit ditët që nuk kanë agjëruar.

**Gruaja shtatzënë dhe ajo me fëmijë në gji** nëse kanë frikë se agjërimi mund t'u shkaktojë dëm atyre vetë ose fëmijës, e prishin agjërimin dhe e zëvendësojnë më pas atë ditë.

### Gjërat që e prishin agjërimin

**Ngrënia dhe pirja.** Allahu i Lartësuar ka thënë: "Dhe hani e pini derisa të dallohet fija e bardhë (bardhësia) e agimit nga fija e zezë (errësira e natës), pastaj plotësojeni agjërimin, derisa të bjerë mbrëmja" (El-Bekare: 187).

**Ndërsa** Mirëpo kush ha ose pi nga harresa, agjërimi i tij është i saktë dhe nuk ngarkohet me faj, siç ka thënë Profeti (Paqja qoftë mbi të!): "Kush harron dhe ha e pi duke qenë agjërueshëm, le ta plotësojë agjërimin sepse Allahu e ka ushqyer dhe e ka gostitur atë". (El-Bukhari 1831, Muslimi 1155).

**Ato gjëra që janë në kontekstin (domethënien) e ngrënies dhe pirjes** siç janë injeksionet (gjilpërat) ushqyese dhe injektimi i gjakut, që e furnizojnë trupin me kripërat dhe ushqimin që i mungon. Këto vijnë në pozitën e ushqimit dhe pijes, ndaj marrin dispozitën e tyre. Po kështu pirja e duhanit - në të gjitha format - e prish agjërimin sepse e furnizon organizmin me helme përmes thithjes së tij.

**Ndërsa** injeksionet (gjilpërat) mjekuese joushqyese nuk e prishin agjërimin.

**Marrëdhënia seksuale** (kur koka e penisit depërton në organin gjenital femëror), edhe nëse ndodh ejakulimi (dalja e spermës), por edhe nëse nuk ndodh. Njësoj gjykohet edhe çlirimi i vullnetshëm i spermës përmes prekjes, masturbimit etj.

**Ndërsa** ejakulimi që ndodh në gjumë - si pasojë e ëndrrave erotike - nuk e prish agjërimin.

**Rrjedhja e gjakut të menstruacioneve dhe lehonisë** Kurdo që të dalë ky gjak, qoftë edhe në fund të ditës së agjërimit, gruas i prishet agjërimi. Po ashtu, nëse gruaja është me menstruacione dhe pastrohet, pasi të ketë aguar dita, atë ditë ajo nuk duhet ta agjërojë dhe nuk i quhet agjërimi.

**Ndërsa** gjaku që del prej gruas për shkak të sëmundjes, pra që nuk është gjak menstruacionesh që vjen në ditë të caktuara të muajit dhe që është i ndryshëm nga ai i lehonisë që del pas lindjes, nuk e pengon gruan që të agjërojë.

**Vjellja me dashje** personi që e provokon me sjelljen e tij vjelljen - dhe ajo del prej tij - konsiderohet se e ka prishur agjërimin.

**Ndërsa** nëse një person vjell në mënyrë të pavullnetshme, ai nuk është përgjegjës për të (nuk i prishet agjërimi). Profeti (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Personi që e kapin të vjellat (pra e mund e vjella pa dashjen e tij) duke qenë agjërueshëm, nuk e ka për detyrë ta zëvendësojë (ditën e agjërimit). Ndërsa ai që e provokon vetë të vjellën, duhet ta zëvendësojë (ditën e prishur të agjërimit)" (Et-Tirmidhi 720, Ebu Daudi 2380).

## Agjërimi
### në popujt e mëparshëm



Allahu ua ligjëroi agjërimin popujve të mëparshëm, edhe pse ai ishte i mënyrave të tjera, sa i përket kohës së agjërimit, afatit të tij dhe gjërave prej të cilave vetëpërmbahej agjëruesi. Gjithsesi, qëllimi i tyre ishte një, adhurimi i Allahut dhe përmbushja e devotshmërisë ndaj Tij. Allahu i Lartësuar na e ka përmendur thënien që Isai (Paqja qoftë mbi të!) ia tha nënës së tij Merjemes, teksa ishte (foshnje) në djep, që nëse të takon dikush, bëju me shenjë se je betuar për Allahun, se do të agjërosh (privohesh dhe vetëpërmbahesh) nga fjalët.

MODERN GUIDE

Projekti: **Udhëzuesi i thjeshtuar i muslimanit**
Këndvështrimi artistik: **Hasen Baharun**
Projektim dhe realizim nga: **Kompania Ed-Delilu El-Muasir**